



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

05-Nr. 06-16690 /2023

Klinë më dt: 18.05 /2023

**PËR:** Komitetin për Politikë dhe Financa-Kryesuesit Z.Fadil Gashi.

**KOPJE:** Kryetarit të Komunës z.Zenun Elezaj,  
-Sherbimi i Kuvendit.

**NGA :** Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim  
Enver Berisha

**LËNDA:** Kerkesë për vuarje në Rend të ditës Raportin e degjimeve më publikun  
Lidhur më Draft buxhetin 2024-2026

Duke u bazuar në kerkesenë e Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të KK të Klinës, Bordi i Drejtorve ka aprovuar kerkesen e Drejtorisë përkatëse për zhvillimin e degjimeve publike për KAB-n 2024-2026.

Arsyeshmeria e marrjes se kësaj procedure, qendronë në faktin se degjimet buxhetore duhet të mbahen në përputhëshmeri më udhëzimin administrativ në fuqi. Prandaj sipas procedurave ju drejtohem KPF-ca dhe Kuvendit Komunal qe kerkesa të aprovohet në tersi.

**SHtojçë: Propozim vendimi**

Me respekt.



Për : Kryetarin e Komunës - z. Zenun Elezaj

Kopje : Drejtorëve të drejtorive

Nga : Zyrtarja kryesore financiare – Melihate Behramaj

Datë, 17.05.2023

01

19.05.2023  
01 401-16756/23

**Subjekti : Njoftim për zhvillimin e procesit buxhetor Komunal 2024-2026**

Bazuar në shkresën e datës 15.05.2023 nga Ministria e Financave dhe Qarkoren Buxhetore 2024/01 , ju njoftoj për zhvillimin e procesit buxhetor Komunal në pajtim me procedurat dhe kalendarin e përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive .

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026, aprovuar në Qeveri përmban prioritetet afatmesme strategjike dhe prezanton burimet e financimit për komunitat për vitet 2024-2026.

Komuna duhet të veproj në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuar në këtë qarkore dhe qarkoret tjera pasuese buxhetore si dhe në përputhje me dispozitat e aplikueshme në fuqi.

Kalendari kohor, hapat dhe veprimet që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2024-2026 janë si në vijim :

- Hapi 1 : Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale( **jo më vonë se më 30 qershor 2023** )
- Hapi 2 : Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale ( drejtoritë )
- Hapi 3 : Kufijtë fillestar specifik për programet ( **para datës 01 korrik 2023** )
- Hapi 4 : Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve
- Hapi 5 : Dëgjimet buxhetore
- Hapi 6 : Përgatitja e dokumentacionit buxhetor
- Hapi 7 : Shqyrtimi i buxhetit të propozuar komunal nga ana e Kuvendit Komunal ( **jo më vonë se më 01 shtator 2023** )
- Hapi 8 : Aprovimi i buxhetit të propozuar komunal nga Kuvendi dhe dorëzimi në MF ( **jo më vonë se më 30 shtator 2023** )

Komuna është përgjegjëse për organizimin kohor të angazhimeve dhe aktiviteteve në përputhje me orarin e hartimit të buxhetit , përfundimin, aprovimin si dhe dorëzimin me kohë të buxhetit Komunal në Departamentin e Buxhet - MF - Data e fundit për dorëzimin e propozim buxhetit komunal të aprovuar është **jo më vonë se 30 shtator 2023**.

## Burimet e financimit Komunal

Tabela në vijim përmbledh totalin e burimeve të financimit për komunë për vitin 2024 - 2026:

Viti	Granti i përgjithshëm	Granti specifik i arsimit	Granti specifik i shëndetësisë	Të hyrat vetanake	Financimi për shërbime rezidenciale	Gjithsej
2024	6.086.118.00	5.453.128.00	1.673.212.00	1.436.260.00	150.000.00	14.798.718.00
2025	6.539.536.00	5.616.721.49	1.756.872.00	1.492.817.00	200.000.00	15.605.946.49
2026	6.965.571.00	5.785.223.00	1.844.716.00	1.567.546.00	200.000.00	16.363.056.00

### Hapi 1 :

Qarkorja buxhetore 2024/01 ofron kufijtë fillestar të financimit për përgatitjen e buxhetit të propozuar komunal, si në tabelën më lartë, dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitet 2024-2026.

Në hapin e parë, hartimi i draftit të Kornizës afatmesme buxhetore për komunë (KAB-it Komunal) nga Zyrtari kryesor financiar, më pas kryetari e dërgon në Kuvend Komunal për diskutim publik.

Duhet të mbahen konsultime me komunitetin dhe palët kyçe të përfshira, përfshirë këtu edhe takimet me publikun për të diskutuar lidhur me prioritetet dhe strategjitë e komunës.

Kuvendi shqyrton, amandamenton nëse është e nevojshme dhe e aprovon KAB komunale.

KAB- i komunal i aprovuar publikohet dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në MF.

### Data e fundit për dorëzim të KAB –it në MF është 30.06.2023

( Përgatitja e vlerësimeve të hershme për secilin program udhëhiqet nga secili drejtor i drejtorisë(programit)sipas vlerësimit të saktë të kostos së programeve dhe aktiviteteve të vazhdueshme.

### Hapi 2 :

Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale.

ZKF dhe drejtorët do të bëjnë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Shqyrtimi i prioriteteve mundëson përcaktimin e prioriteteve në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor.

### Hapi 3 :

Kufijtë fillestarë specifik për programet në bazë të rezultateve të shqyrtimit të prioriteteve .

### Rekomandohet që kufijtë fillestarë të programeve të caktohen para datës 01 korrik 2023

### Hapi 4 :

Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve

Drejtorët do të dorëzojnë materialet buxhetore tek ZKF.

### Hapi 5 :

Dëgjimet buxhetore .

ZKF në konsultim me kryetarin do t'i shqyrtoj buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga programet dhe do të mbaj seanca dëgjimore për secilin program.

**Hapi 6 :**

Përgatitja e dokumentacionit buxhetor.

Pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe takimeve me publikun, ZKF do të përgatis dhe dorëzoj kryetarit buxhetin e propozuar komunal për secilin nga 3 vitet vijuese fiskale (2024-2025-2026).

**Hapi 7 :**

Shqyrtimi i buxhetit të propozuar komunal nga Kuvendi Komunal

**Ky shqyrtim duhet të bëhet jo më vonë se më 01 shtator 2023**

**Hapi 8 :**

Aprovimi i buxhetit të propozuar Komunal nga Kuvendi dhe dorëzimi në MF .

Propozim buxheti Komunal për vitin 2024 duhet aprovuar nga Kuvendi Komunal **jo më vonë se më 30 shtator 2023** dhe njëkohësisht të dorëzohet në Departamentin e Buxhetit Komunal në MF.

**Shtojcë :**

Drejtorët duhet t'i bëjnë propozimet për buxhet sipas kësaj Deklarate :

Emri i drejtorisë: \_\_\_\_\_

DEKLARATA E MISIONIT :

DEKLARATA E VIZIONIT :

DEKLARATA E QËLLIMIT:

Performancë:

	Kategoritë buxhetore	2024	2025	2026
1	Paga dhe medijtje			
2	Mallra dhe shërbime			
3	Komunali			
4	Transfere dhe subvencione			
5	Kapitale			
	TOTALI			

Numri i të punësuarve			
-----------------------	--	--	--

	2024	2025	2026
Kuantitative			
1.			
Kualitative			
1.			

Drejtori LENGUËR BERISHA  
Data 19.05.2023



P.S: Këtij njoftimi i bashkëngjisim Qarkoren Buxhetore 2024/01 nga MF

Tabela 6. Korniza Buxhetore Komunale në euro sipas Qarkores së parë

Përshkrimi	2023	2024	2025	2026
	Viti aktual	(planifikim)	(planifikim)	(planifikim)
<b>1 TË HYRAT TOTALE</b>	<b>13.051.595.00</b>	<b>14.798.718.00</b>	<b>15.605.946.49</b>	<b>16.363.056.00</b>
1.1 Të hyrat vetanake	1.373.774.00	1.436.260.00	1.492.817.00	1.567.546.00
Grantet dhe transferet				
1.2 qeveritare	11.677.821.00	13.362.458.00	14.113.129.49	14.795.510.00
<b>2 SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE</b>	<b>13.051.595.00</b>	<b>14.798.718.00</b>	<b>15.605.946.49</b>	<b>16.363.056.00</b>
2.1 Shpenzimet rrjedhëse				
Pagat dhe medijtjet	6.753.688.00	7.648.500.00	8.030.925.00	8.432.471.25
Mallrat dhe shërbim	1.660.000.00	1.710.000.00	1.795.500.00	1.885.275.00
Shërbime komunale	200.000.00	250.000.00	262.500.00	275.625.00
Subvencionet	400.000.00	500.000.00	555.000.00	569.562.19
2.3 Shpenzimet Kapitale	4.037.907.00	4.690.218.00	4.962.021.49	5.200.122.56



REPUBIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. \_\_\_\_\_ 2023

Klinë, 28. 03. 2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 28. 03. 2023, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Kuvendit të Komunës, nënkryetarja e Komunës, drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE, Mediat lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 27 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi që në fillim kërkoi që të lexoj një raport të Kuvendit të nxjerrë në vitin 2013, për këtë deklaroi që do të dalë në foltore.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Motivi që po ju drejtohem juve ka një arsye se në atë kohë kam qenë edhe unë anëtar i kuvendit. Përveç kësaj jemi në muajin prill që ka krijuar shumë përkujtime dhe shumë ngjarje. Muaji është karakterizuar me përvjetorë e dhimbje masive. Klina e ka datën 4 prill ditën e të zhdukurve të luftës e dje ishte ditë në nivel të Kosovës. Tjetër këtë muaj e karakterizon viti 2013 ku me datë 26 prill të këtij viti ky kuvend e ka miratuar një raport për dëmet e luftës. Një komision që është ndërtuar prej këtij kuvendi i cili pas hulumtimeve, bashkëpunimit të madh me organizata dhe institucione ka ndërtuar këtë raport.

Qysh në vitin 2013 kemi një raport që në tërësinë e tij as atëherë as tani nuk kemi pretenduar që është krejtësisht i saktë por afër 90% është i saktë. I ka adresuar saktë shumicën e dëmeve të krijuara gjatë luftës nga agresori.

Në vazhdim z. Gashi bëri përshkrimin e raportit më më në detaje. Për ta përfunduar me shqetësimin e mos marrjes së organeve tona më këtë raport duke e ditur që dëshmitarët të përfshirë me kalimin e viteve edhe po vdesin. Ky kuvend me këtë raport ka nxjerr edhe rekomandime duke jua drejtuar institucioneve përkatëse dhe përgjegjëse.

z. Fadil Gashi lexoi rekomandimet e kuvendit bashkangjitur raportit në fjalë duke theksuar se ka mbledhur informata zyrtare dhe deri me at kemi 877 padi nga qytetarët serb kundër institucioneve tona. 210 padi janë civile ndërsa të tjerat janë kundër institucioneve tona për dëmet e luftës ndërkohë që ne edhe përkundër vrasjeve masive që na janë bërë e dëmeve qysh edhe shihet në raport, nuk kemi ngritur asnjë padi. Ky raport nuk akt ë bëjë kundër asnjë pjesëtari të komunitetit serb, ata le te ndjehen komod dhe të sigurt, ne kemi të bëjmë vetëm me akteret e këtyre dëmeve.

z. Fadil Gashi e përfundoi fjalimin e tij duke uruar që duke kujtuar këtë raport sot në këtë kuvend dëshiron që të i bëhet edhe një herë një alarm për drejtësinë dhe institucionet e tona që të ndërmarrin veprimet ligjore.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje të gjithëve. Kam dy falënderime për këtë raport që posa e lexuat. Falënderoj komisionin që e ka përgatit këtë raport dhe faleminderit juve që e rikujtuat. Vërejte kam pa dallim për të gjitha institucionet që këtë raport e kanë lënë në sirtar. Rekomandoj që të zgjidhet një komision ose të bëhet një rekomandim për zyrën ligjore që të hulumtoj dhe të kryej obligimet zyrtare sa i përket këtij raporti.

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Përshëndetje të gjithëve. Ndjem mirë dhe krenar që kam qenë pjesë e atij komisioni. Sa i përket procedurës , dua të ju siguroj se edhe materiali është prezent të ne, janë bërë veprimet e duhura edhe nga niveli lokal edhe qendror. Klina është një ndër komunat e para që ka bërë një punë të tillë. Është mirë që të iniciohet edhe nga ne por organet përgjegjëse i kanë të gjitha këto shënime , deri ku ka shkuar procedura nuk mund ta dimë ne.

**z. Arben Limanaj:** Edhe ne si grup e mbështesim iniciativën e theksuar nga kryesuesi. Dëshiroj që të kërkoj nga ju kryesues që nëse shihet e nevojshme për plotësim të tij raporti, ju informoj se ekzistojnë video të asaj kohe të bëra nga një ekip vullnetar të cilëve jua patëm paguar vetëm shpenzimet teknike. Pra, janë të gjitha video dhe foto që dokumentojnë dëmet e luftës dhe janë të ruajtura në arkivin e komunës.

**z. Valmir Baca:** Përshëndetje. Ne shpesh e dëgjojmë nëpër media se Kosova nuk ka bërë asgjë sa i përket dëmeve të luftës, Kjo që ka bërë komuna e Klinës e demanton këtë gjë. Besoj që tani pasi që po ri iniciohet kjo do të jetë një alarm për institucionet dhe do të ndërmerret ndonjë gjë.

**z. Zafer Gashi:** Përshëndetje. Ju përgëzoj për iniciimin e këtij raporti. Është shumë me rëndësi ajo që është shënuar në fund të atij raporti ku kuvendi i Klinës rekomandon që në bisedimet me Serbinë të jetë temë edhe Dëmet e shkaktuara gjatë luftës në Klinë. I përgëzoj të gjithë anëtarët e atij komisioni por dua të përmendi disa emra të cilët qysh



në qeverisjen e parë të përkohshme lokale kanë kontribuar në grumbullimin dhe mbledhjen e fakteve siç janë, z. Habib Morina, Isni Raci, Zeqir Morina, Kamer Raci etj. Si duket ndër vite nga qeveritë është neglizhuar dhe nuk kanë pasur vullnet që të merren me këtë çështje. E tha mirë kryesuesi se ky raport nuk është kundër qytetarëve serb por ne e dimë , jemi dëshmitarë që në Klinë vijnë dhe shkojnë njerëz të cilët gjatë luftës kanë vra, kanë marrë pjesë në masakra dhe askush nuk lajmërojnë institucionet. Duhet të merret policia me ta sepse denoncime ka. Nuk pres gjë të mirë nga një person që merr pjesë në barrikada dhe sot është në punë në administratë.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Adresimi im ka qenë vetëm sa të ngritët edhe një herë shqetësimi i të gjithë neve. Nuk janë pak 10 vite prej që është bërë ai raport. Tani ose duhet të merren në intervistë dhe të japin llogari krejt kuvendi i asaj kohe për atë raport ose është dashtë të merren masa të tjera dhe të shqyrtohet seriozisht ai raport. Nuk amnistohet asnjë institucion i shtetit që ai raport ka ngeluar pa u shqyrtuar dhe marrë me të. Ky raport nuk ka pas dhe nuk ka ngjyra politike. Secila qeveri në vijimësi është dashtë që ta merr si të nevojshëm. Edhe një herë e theksoi se ky raport nuk ka të bëjë asgjë kundër qytetarëve serb por vetëm ashtu siç e thotë raporti.

Kryesuesi e përfundoi fjalën e tij duke theksuar se fjala e jonë publike që po e themi tani besoj që do të i nxis organet tona që të fillojnë të merren me këtë raport.

**z. Kolë Prenaj:** Përshëndetje. Unë kam qenë në asamble kur është aprovuar ky raport unanimisht përveç një votë kundër nga një asamblist i komunitetit serb. Kam qenë në ngjarje edhe para luftës edhe gjatë luftës. Në atë kohë ka funksionuar KMDNJ. Unë jam i interesuar për pasurinë time, a kanë hy të gjitha deklaratat edhe të këshillit për drejtat e njeriut pyes. Nuk kam ndonjë informacion konkret. Curr Racin e kam pasur koleg, shok, kush e ka vra dihet, fëmijët e tyre vijnë bëjnë tregti këtu. A ka marr dikush ndonjë veprim konkret.

**Znj. Lirie Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Mora fjalën në emër të grupit të anëtarëve të komisionin për transportin e nxënësve. Ne kemi shqyrtuar kërkesat që kanë ardhur tek ne dhe në bashkëpunim me DKA. Duke llogaritur që tani është 50% e shpenzimeve të mbuluara shpresojmë që në të ardhmen të bëhet 100%.

Kryesuesi Gashi në emër të kuvendit falënderoj komisionin në fjalë për transportin e nxënësve dhe ai tha se me dorëzimin e këtij raporti nga znj. Gashi pushon mandati i këtij komisioni.

Për rendin e ditës, kryesuesi tha se i ka tre kërkesa shtesë të cilat i lexoi.

1. Kërkesa për anulimin e vendimit për bartje të mjeteve dhe shpërndarja e mjeteve nga të hyrat vetanak nga viti 2022-2023.(346000 euro)
2. Draft rregullorja e kërkuar nga ministria që të aprovohet për bonuset e zoonimit në komunën e Klinës.
3. Bartja e pronësisë nga titullari nga shkolla në Dollc në pronësi të komunës së Klinës.

Kryesuesi hapi debat për Rendin e Ditës.

z. Esat Raci kërkoi që në seancën e Majit të raportohet nga Komisioni për hulumtimin e procedurave për dhënien e lejeve për fabrikë të çimentos.

Kryesuesi Gashi tha se janë 13 pëlqime që i ka dhënë ministria. Ai tha se i ka të gjitha pëlqimet i ka mbledh këto sepse është marr me analizën e hapësirës së kërkuar nga OVL e UCK që të vendosen tre shkronjat UCK në një hapësirë të lartë. Për raportin e komisionit, ju që jeni anëtarë të atij komisioni nëse nuk raportoni bëni vepër penale. Nuk po kërkoi as fajtorin as jo fajtorin por ju keni bërë intervista dhe keni marr përsipër që të kryeni punën, keni përgjegjësi, tha z. Fadil Gashi.

**z. Valmir Bacaj:** Po flas në cilësinë e anëtarit të atij komisioni. Ne e kemi përfunduar punën si komision, të gjitha atë punë e ka kryesuesi i komisionit. Unë po ju them se në raport nuk akt ë gjetura por po mundohet të përfitohet politikisht. Përgjegjësia është individuale.

Kryesuesi edhe një herë lutet që raporti mos të përdoret politikisht. Ju si komision nëse nuk keni raport duhet të vini të deklaroni se s` ka raport ose atë raport ta dorëzoni. Ju më keni marr edhe mua intervistë dua të dijë se çka është bërë me atë intervistë timen. Nuk jam duke paragjykuar asgjë unë, tha kryesuesi.

z. Esat Raci theksoi se nuk është politike fare kërkesa që të raportohet. Neve na intereson të dimë se si është ai raport dhe të kryhet puna e atij komisioni.

z. Zafer Gashi theksoi se në atë komision ka qenë edhe ai vet nga LVV. Z. Gashi tha se mendon që ka të gjetura dhe ato të gjetura janë të shkuara dhe nëse nuk vjen kryesuesi i komisionit që është jashtë kuvendit atëherë ne duhet ta përfundojmë atë raport duke dhënë vlerësimin e pikave të raportit. Ka që gjatë deklaratës është bërë shkelje e betimit, ndryshe është deklaruar fillimisht dhe ndryshe më vonë.

z. Valmir Bacaj theksoi se puna e komisionit ka qenë hetimi i dhënies së leje që komuna i ka dhënë. Procedurat e nivelit qendror nuk akne qenë punë e jona. Z. Bacaj kishte një kërkesë nga Zafer Gashi që ta mbaj deklaratën e bërë këtu në Kuvend kur ka thënë se e ka nënshkruar atë raport. Le të na sjell atë raport të nënshkruar pra.

z. Zafer Gashi tha se unë raportin e kam marr nga kryesuesi i komisionit dhe e kam nënshkruar, pse nuk jua ka dhënë të tjerëve të nënshkruajnë raportin unë nuk e diji.

Kryesuesi tha se me rëndësi është që të përfundoj puna e komisionit që për këtë punë keni kohë një muaj. Ne si kuvend duhet ta dimë se çka po bëhet me atë raport.

**Me 27 vota për aprovohet Rendi i Ditës.**

**Pika 1 Arsyetimi i Mungesave. Present janë 27 anëtarët e kuvendit.**

**Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

z. Fadil Gashi kishte një vërejtje të vogël për procesmbajtësin se procesverbali po bëhet shumë i gjatë. Ai tha se për zgjerimisht kush dëshiron mund ta marr incizimin e seancës. Kërkoj nga procesmbajtësi që procesverbali të shkruhet më shkurt.

### **Me 27 vota për bashkë më vërejtjen e bërë u MIRATUA**

#### **Pika 3 e Rendit të Ditës: Rekomandimet e KPF-së**

**Me 27 vota për u MIRATUAN rekomandimet e KPF-së.**

#### **Pika 4 e Rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar Janar-Mars 2023**

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZh:** Përshëndetje të gjithëve. Ashtu siç e parasheh ligji për buxhet dhe ligji për financa, ne jemi të obliguar që të raportojmë para kuvendit çdo tre muaj. Ky buxhet dhe ky planifikim për vitin 2023 është i bazuar mbi këtë ligj dhe i aprovuar nga kjo asamblë vitin e kaluar. Fillimisht ju njoftoj se gjatë hartimit të këtij buxheti është precizuar edhe situata e obligimeve të mbetura.

Gjatë raportimit, drejtori mes të tjerash theksoi se janë 51000 euro të bartura nga viti i kaluar nga mallra dhe shërbime dhe po ashtu shpenzimet komunale 37594 euro të bartura nga viti i kaluar. Këto janë shpenzime më të mëdha se sa ai i vitit të kaluar ën të njëjtën periudhë. Po ashtu drejtori Berisha foli për shpenzimet e tjera, të hyrat vetanak, grumbullimin e të hyrave vetanak në shifra dhe sipas z. Berisha gjithçka është normale dhe sipas planifikimit të bërë. Me gjithë hamendjen e qytetarëve se a duhet paguar tatimin në pronë në vlerë prej 100 eurove që ka udhëzuar qeveria, ata janë përgjigjur kënaqshëm, tha z. Berisha.

Sipas drejtorit Berisha janë dy fazat e vërsimeve që kanë qenë sfida dhe kanë krijuar shpenzime si në derivate dhe të tjera. Ndërsa projekti i serave po ashtu ka krijuar shpenzime pasi që janë mbi 200 familje që janë vizituar. Po ashtu shpenzime më të mëdha se sa vitin e kaluar në të njëjtën periudhë janë edhe ato të telefonisë pasi që në periudhën e njëjtë vitin e kaluar ka qenë lpko dhe tani është Vala që duket se është më e shtrenjtë.

**z. Ndrec Zefaj:** Përshëndetje. E kam lexuar raportin financiar dhe të njëjtën kohë kam shkoqitur dy pika që mendoj se duhet të i raportojmë në kuvend. Të hyrat Komunale tek të hyrat vetanak. Krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin 2022 është më e ultë për 12.3%. Si pikë e dytë është performanca e shpenzimeve, shpenzimet kapitale. Është mjaftë shqetësuese sepse në tre mujorin e parë kemi shpenzime tek kjo kategori vetëm 1.6%. nëse vazhdohet me këtë trend në fund të vitit do të kemi suficit buxhetor.

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Si duket nuk u kuptuam sa duhet me sqarimin tim. Asnjë më pak nuk ka të hyra tek tatim paguesit përveç ndalimit të qeverisë që ju ka bërë qytetarëve me atë faljen e 100 eurove. Po ashtu sa i përket shpenzimeve kapitale ne do ta arrijmë kuotën e duhur gjithsesi.

z. Ndrecaj dhe z. Berisha diskutuan edhe më tutje me pajtim - mospajtim në lidhje me atë që shprehu z. Ndrecaj në fjalën e tij të parë.

z. Enver Gashi, shprehu kënaqësinë për trendin e uljeve të disa shpenzimeve por foli për disa shqetësime në lidhje me rritje të disa shpenzimeve të tjera si ajo e telefonisë, karburanteve etj.

z. Esat Raci shtroj disa pyetje duke thënë se diku rreth 10% ka rritje të shpenzimeve. Ai tha se ka dëshirë ta diji tek mbeturinat, tek shpenzimet e telefonisë mobile pse rubrika është e zbrazet në tabelar. Tek dreka zyrtare tha se kjo qeveri shihet që ka nisë me e rrit luksin pak.

z. Zafer Gashi, tha se shqetësimi i tij është tek investimet kapitale. Mallrat dhe shpenzimet që janë bërë shumë pagesa ndërsa investimet kapitale akne ngelur shumë pak. Z. Gashi theksoi se shpenzimet e bëra tek anëtarësimi në oden e mjekëve, çdo tre muaj shumat po i kalojnë 3000 euro. E diji që kemi mungesë të mjekëve s` di sa mjek anëtarësohen në oden e mjekëve çdo tre muaj. Po ashtu shumta e madhe e shpenzuar për tre muaj është edhe tek telefonia mobile, tha në fund z. Gashi.

z. Valmir Bacaj, deklaroi se këtë raport e kemi analizuar dhe kemi bërë krahasime me vitin e kaluar. Ai në vazhdim tha se kuptoj rritjen e shpenzimeve tek pagat janë 2130 euro më tepër. "Shpenzimet që po thuhet shpenzime të luksit janë më pak se vitin e kaluar. Shpenzimet e telefonisë mobile edhe kjo kuptohet pasi që është ndërruar operatori. Ulja e tatimit në pronë ka ndodhur për shkak të njoftimit të qeverisë me parashikimin e faljes prej 100 euro dhe unë këtu dua të ju them qytetarëve që edhe nëse paguajnë tatimin në pronë dhe ndodhë falja , ajo shumë do të ju rimbushet", tha, z. Bacaj.

z. Fadil Gashi, kryesues tha se qytetari ka ardhë në situatë të mendoj se a duhet paguar tatimi në pronë a nuk duhet shkaku i këtij vendimi të qeverisë. "Në vendim nuk shkruan askund që do të rimbushen prandaj nuk jam shumë dakord me atë që e tha në këtë pjesë z. Bacaj", tha kryesuesi. Z. Gashi tha gjithashtu se nuk është aspak dakord me centralizimin e lidhjes së kontratave të OE me qeverinë për furnizim të zyrave në komunë e shkolla sepse ka shumë parregullsi në furnizim e sidomos vonesa.

Në fjalën e kryesuesit kishte reagim nga anëtari i LVV në Kuvend, z. Zafer Gashi por edhe kundër reagim të kryesuesit z. Fadil Gashi.

Drejtori i FEZh ,z. Enver Berisha në fund u përgjigj edhe për shqetësimin e pagesave për "Ambientin" duke e specifikuar dhe arsyetuar rritjen e shpenzimit. Po ashtu edhe për dreka shpjegoj që janë më shumë dreka që epen kur punëtorët dalin në pension. Ndërsa shpenzimet e vogla në investime kapitale tha se këto nuk mund të bëhen në janar e shkurt sepse është dimër.

z. Kushtrim Haliti tha se dëshiron që të shpreh shqetësimin për rrugën e Dollcit të shtruar në dhjetor e që është prishur e tëra. Po ashtu edhe ura në Pogragjë është demoluar nga vërshimet përkundër investimit të vonshëm.

Në shqetësimin e Kushtrim Halitit u përgjigj z. Enver Berisha drejtor i FEZh.

**Pika 5 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të drejtorisë së FEZh për bartjen e mjeteve financiare.**

Kryesuesi z. Gashi tha se shkresën nga kjo drejtori e keni marrë, aty shihet që është fjala për bartjen e dy shumave . njëra në vlerë 6000 euro dhe tjetra në vlerë prej 7820 euro. Janë në kategori dhe nën kategori prej nga dhe ku barten.

**Me 26 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për krijimin e kodit të ri për participim në sera.**

Kryesuesi theksoi se edhe në KPF është thënë se është hera e fundit që miratojmë një këso shkresë sepse duhet të vijë me kohë kjo kërkesë para se të fillohet me sera.

Z. Lorenc Marleku drejtor i Bujqësisë shpjegoi që s` ka pas mundësi me e sjell më herët kërkesën sepse nuk është ditur shuma. Ndërsa kryesuesi replikoi duke thënë se nuk po e diskutojmë shumën por kodin, kodi i ri për participim duhet të caktohet më herët se sa të filloj ndarja e serave.

**Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për vënie në diskutim publik të draft statutit të QKMF-së**

**Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 8 e Rendit të Ditës: Kërkesë për emërtimin e një rruge me emrin Willy Kuypers**

Kryesuesi tha se është dakordim nga kryetari, komisioni për rrugë për emërimin e një rruge me emrin e këtij humanisti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

**Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të zyrës për komunitete dhe kthim për vënie në diskutim publik të draft planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.**

**Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 10 e Rendit të Ditës: Anulimi i vendimit për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanak nga viti 2022 në vitin 2023.**

**Fillimisht vendimi u anulua me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

## **Propozim vendimi i ri për bartje me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

### **Pika 11 e Rendit të Ditës: Anulimi Draft rregullore për bonuset e zoonimit në komunën e Klinës**

Kërkohet anulimi i vendimit për vënie në diskutim publik të kësaj draft rregulloreje edhe pse jemi bazuar në rregulloren që na obligon për vënie në diskutim publik të kësaj rregulloreje tha z. Fadil Gashi, kryesues. Me gjithë këtë ne jemi duke e shqyrtuar sipas kërkesës së tyre, tha z. Gashi.

### **Votohet rishqyrtimi i kësaj rregulloreje dhe me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA rishqyrtimi.**

### **Pika 12 e rendit të Ditës: Bartja e pronës nga pronësia e shkollës “Dositije Obradovic” në Dolc në pronësi të Komunë së Klinës**

**Kryesuesi tha se kërkohet formalisht ky vendim dhe e vuri në votim**

**Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

### **Pika 13 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje**

Kryesuesi kërkoi që të bëhen vetëm nga një pyetje nga një anëtar i kuvendit ose e caktojme minutazhen sipas rregullore prej 15 minutave në tërësi. Kjo nuk u mirëprit nga grupet opozitare por kryesuesi tha se mundësia e anëtarëve për thirrje në interpelancë është e mundshme në mënyrë që të këtë më shumë mundësi diskutimi.

**z. Ndrec Zefaj:** Për drejtorin e arsimit. Është lëshuar një vendim për mbylljen e çerdhes së fëmijëve” Xhevë Lladroci” me arsye për renovim. Pse po ndodhë tani e jo ën muajin Gusht kur fëmijët janë pushim.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Vendimi nuk ka qenë nga DKA në Klinë por nga inspektorati i arsimit të cilët akne kërkuar që tani të bëhet renovimi. Nuk kemi qenë dakord por gjithsesi ata kanë këmbëngulur .

**z. Zafer Gashi:** kam kërkesë për kryetarin e Komunë she ekzekutivi që ta kemi listën e personave përfitues nga rasti i parë i vërshimeve. Po ashtu një pyetje për mjetet e ndara për veteranin Sokol Gashi. Kryetari herën e fundit ka thënë se ajo çështje e votuar këtu në kuvend është në procedurë por akoma nuk janë realizuar derdhja e mjeteve të ndara nga Kuvendi. Pyetje kam edhe për drejtorin e Shërbimeve Publikë, fjala është për një qytetar i cili edhe juve ju ka njoftuar edhe pse nuk është komplet kompetencë e juaja, unë ju lutem që të i ndihmoni që të bëni një lloj presioni mirëdashës tek KEC a Kesh për heqjen e një shtylle elektrike ne derë të oborrit të z. Januz Haxhaj.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Neve edhe në Sferkë kur i kanë ndërruar shtyllat në momentin e fundit na kanë njoftuar. Ne kemi një lloj bashkëpunimi por ajo është kompani private që nuk i jep shumë llogari Komunës.

**z. Kushtrim Haliti:** Po bëhen tre muaj nga votimi i raportit të fundit për vërshime, a ka ndërmarr ndonjë veprim qeveria për kompensime. Për drejtorin e Urbanizmit: Nëse një qytetar aplikon për leje për ndërtim sa është afati ligjor me ja kthyer përgjigjen? Dhe nëse skadon afati ligjor si duhet të veprohet? Dhe për drejtorin e Inspektoratit: Për pronën publike që e kam diskutuar këtu në seancën e kaluar, pronë komunale e uzurpuar në mes të qendrës a keni marr ndonjë masë a veprim?

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Ne kemi pasur takim me nivelin qendror nuk kemi marrë përgjigje zyrtare akoma se a është pranuar apo jo raporti. Sa i përket pyetjes së znj. Valmire Krasniqi nga seanca e kaluar në lidhje me qentë endacak, e kemi rritur buxhetin nga 20 mijë euro në 30 mijë euro për trajtim dhe pas një jave mbyllet tenderi ku pastaj do të kemi procedurë të kontratës.

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit:** Lejet e ndërtimit janë dy kategori. Kategoria e parë e cila i ka 30 ditë për shqyrtim dhe kategoria e dytë i ka 45 ditë. Brenda afatit 30 ose 45 ditë mund të kërkohen dokumentacione shtesë dhe nëse qytetari nuk ofron dokumentet e kërkuara afati mund të zgjatet. Paraprakisht duhet nxjerrë kushtet ndërtimore e pastaj leja e ndërtimit edhe kushtet ndërtimore akne një afat, kategoria e parë 15 ditë dhe e dyta 30 ditë. Nëse nuk shqyrtohet me kohë dhe fajtor është zyrtari atëherë mund të jetë aprovim në heshtje por edhe aprovimi në heshtje bazohet në ligje aktuale.

**z. Faruk Smajli, drejtor i inspektoratit:** Parkingu në fjalë është i pajisur me leje pune dhe leje për shfrytëzim në Vitin e kaluar. Për këtë vit është një vendim i publikuar në ueb të komunës që ju ka dhënë mundësi të gjithë shfrytëzuesve të hapësirave publike që deri me 31 mars të lirojnë hapësirat ose të aplikojnë për leje për shfrytëzim. Biznesi në fjalë ka aplikuar dhe është në procedurë.

**z. Kushtrim Haliti:** Unë kam qenë në drejtori dhe kam marr informacione në drejtorinë e urbanizmit. Biznesi në fjalë nuk ka bërë asnjë kërkesë për shfrytëzim të pronës. Qe 4 muaj ai as nuk ka paguar asgjë dhe as nuk ka aplikuar për leje për shfrytëzim.

**z. Faruk Smajli, drejtor i inspektoratit:** Kur ta merr në shfrytëzim do ta bëjë pagesën për tërë vitin komplet. Biznesi në fjalë është në procedurë për marrje në shfrytëzim.

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Biznesi në fjalë i ka paguar vitin e kaluar komplet është fatura në drejtori të financave, këtë vit nëse e merr do të paguaj përsëri.

**z. Tunë Dedaj:** Kam një pyetje nga drejtori i inspektoratit, pse tek ne nuk zbatohet ligji për duhanin?

**z. Faruk Smajli, Drejtori i Inspektoratit:** Është në kompetencë të AVUK që të kontrollojnë se si zbatohet ligji për duhanin. Nëse kërkohet nga ne prej AVUK ne do të dalim bashkë me ta në inspektim.

**z. Asdren Ramadani:** Kam një pyetje për drejtorin e urbanizmit. Kur do të filloj projekti për rregullimin e rrugës së gjimnazit për ndërtimin e trotuarit? Pyetje për z. Millaku: A

mund ta dijë kush menaxhon parkingun e shtëpisë së kulturës sepse aty punëtorët e kulturës nuk po gjejnë vend për parkim.

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit:** Ne kemi kërkuar që të bëhet një projekt tjetër sepse ai projekt nuk i plotëson kriteret. Mendoj që shumë shpejt do të vijmë tek një operator që do të bëjë projektin dhe më pastaj të procedojmë. Këtë vit do ta realizojmë.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Kemi shpallur procedurën por është e zorshme që të sigurohet parking për të gjithë punëtorët e Komunës.

**Znj. Blerina Gashi:** Kur është afati i fundit të përfundimit të kontratës së ujësjellësit për Gjurgjevik të Madh?

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Ky projekt është i CDI por problemi është edhe tek KEDS të cilët kanë kërkuar leje për trafo tek pusi i Jerinës dhe Ujmir. Besoj së shpejti do të përfundoj por është procedurë e KEDS.

**Znj. Valmira Krasniqi:** Kam një pyetje për drejtorin e SHP. Tek rruga në fshatin Perqevë në një pjesë nuk është bërë ndriçimi publik, pse nuk është bërë vetëm sepse janë të LVV? Dhe në seancën e kaluar të kam pyetur për rregullimin e trotuarit tek lumi, ku është dëmtuar nga vërshimet.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Për trotuarin ndoshta është mirë që të pyetet drejtori i urbanizmit ndërsa sa i përket ndriçimit publik në Perqevë do at rregullojmë gjithandej gjithsesi sepse punojmë pa dallime partiake.

**z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit:** Sa i përket trotuarit ne kemi pasur pengesa për shpronësim të pronave private.

**Znj. Valmire Krasniqi:** Nuk e kisha fjalën për trotuare te reja por trotuare të dëmtuara nga vërshimet nën urën e hekurudhës.

**z. Arben Limanaj:** Një qytetar nga Leskoci mi dërgoi disa foto të dëmtimit të pronës së tij. Nuk e diji për çfarë projekti bëhet fjalë, shihen të mbjellat e tij të dëmtuara.

**z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit:** Projekti është duke u realizuar në Leskoc dhe Ranoc. Kemi disa pjesë që duhet të rregullohen- bankina. Operatori ka bërë disa dëmtime , kam qenë në vend të ngjarjes dhe kam folur me operatorin që të bëjë rregullimin . Nuk është aq alarmante sa po flitet. Janë dëme shumë të vogla.

**Znj. Ilirjana Toplanaj:** Dua të ju informoj që kemi themeluar grupin grave asambliste dhe me përkrahjen e të gjitha grave jam zgjedhur kryetare e grupit. Për mbledhjen e këtij grupi do të ju informoj përmes telefonit.

Informimi nga zonja Toplanaj ishte e fundit për këtë seancë të rregullt të punës të cilën kryesuesi pasi falënderoj të gjithë anëtarët dhe të pranishmit e shpalli të mbyllur.



Procesmbajtës:  
Skënder Behramaj

Kryesuesi:  
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. Org. / Org. Jedin / Org. Unit	01/4/ko	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No:	1026/2023
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages:	9	Data / Datum / Date:	15.05.23
Hyrëse	PRISHTINE/A		

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere /  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

*Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister*

DATË/A:	15.05.2023
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar,
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2024/01

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2024.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2024/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror dhe kufijtë buxhetor të nivelit komunal për vitin 2024-2026. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit të ndarjeve buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Me respekt!

Hekuran Murati  
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



## Qarkorja Buxhetore 2024/01

### 1. Qëllimi

Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren buxhetore 2024/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026, kalendarin kohor indikativ dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026 për çdo organizatë buxhetore. Në rast nevoje, pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkoret e tjera shtesë deri në finalizimin e buxhetit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026.

### 2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2024-2026

Planifikimi i buxhetit për vitin 2024 bazohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2024-2026. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2024-2026, sipas prioriteteve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar nëpërmjet Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe strategjive sektoriale, si dhe dokumentet që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian sikurse Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Rtjedhimisht, prioritetet e Qeverisë për periudhën e ardhshme trevjeçare janë fokusuar në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjes së punësimit dhe një zhvillimi të qëndrueshëm, që mbron ambientin duke e ruajtur atë edhe për gjeneratat e ardhshme, si dhe orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale të KASH 2024-2026 kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2024, dhe vlerësimet për vitet 2025-2026. Çdo tendencë për tejkalim të kufijve të shpenzimeve mbi kufijtë e kësaj qarkoreje e bën të detyrueshëm ndryshimin përkatësisht rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2024/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negociim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

### **3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2023**

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2024, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit deri në fund vit të buxhetit të vitit 2023 në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për nën shpenzimet eventuale në buxhetin aktual, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2024, dhe vlerësimeve për 2025-2026.

### **4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2024-2026**

Procesi buxhetor për vitet 2024-2026 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në prioritetimin e sektorëve buxhetor në KASH 2024-2026. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara në KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm në bazë të hapësirës së lirë fiskale dhe nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2024-2026. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2024-2026 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike. Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale, duke përfshirë obligimet e shpronësimit lidhur me ato projekte;
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues dhe
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
  - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale;

- Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të dërgojnë në MFPT informatë lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
- OB-të në nivel qendror dhe lokal të deklarojnë në MFPT numrin e pozitave të lira e të paplotësuara për të cilat OB nuk ka marrëdhënie punësimi dhe për të cilat nuk ka buxhet për plotësimin e tyre.
- OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të eliminojnë keq klasifikimet të shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analisti buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largojë nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
- Projektet e propozuara të jenë projekte në përputhje me Manualin e PIP dhe UA për **Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale** si dhe UA për **Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale**. Projektet të cilat nuk zbatojnë kërkesat kryesore të manualit dhe udhëzimeve administrative, nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
- Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas manualit të PIP dhe udhëzimeve administrative, që përfshinë edhe kriterin e përputhshmërisë së projektit/aktivitetit të propozuar me strategjinë dhe KASH-in 2024-2026;
- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
- Ministritë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën. Nuk do të lejohen projekte të reja në nivel qendror të cilat sipas legjislacionit në fuqi janë kompetenca komunale;
- Buxhetimi i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.
- Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Vëmendje e shtuar do t'i jepet në vijim të këtij procesi nga MFPT zbatimit të kërkesave të lartpërmendura dhe vërejtjet do të regjistrohen nga analistët e buxhetit në sistemin PIP.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe duhet të fokusohen në këto fusha: drejtësi dhe ligj; ekonomi dhe punësim; arsim; shëndetësi; siguri; integritet euro-atlantike; dhe mjedis.

**Shpenzimet rrjedhëse:** organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcat e bashkangjitura.

**Punësimi:** Nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti.

**Pagat dhe shtesat:** *Ligji pagave për sektorin publik është aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe i publikuar në gazetën zyrtare me dt.05.01.2023 dhe si i tillë ka filluar aplikimin nga muaji Shkurt i vitit 2023.*

Për kalkulimin e pagave për vitin 2024 është marrë për bazë për përlllogaritje muaji mars 2023 dhe për punëtorët aktual është llogaritur shumëzuar me 12 muaj. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përlllogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm 30%, brenda kufizimeve buxhetore.

Kjo kategori e shpenzimeve mund t'i nënshtrohet ndryshimit për organizata buxhetore varësisht prej zbatimit të procesit të ekuivalencës.

**Mallra dhe shërbime:** Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

**Shpenzimet komunale:** priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2023.

**Subvencionet dhe transferet:** Subvencionet dhe transferet, pritet të rriten mesatarisht me rreth 3.7%. Do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikatat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

**Shpenzimet kapitale:** përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 23.9% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve.

Për organizatat buxhetore të cilat konkurrojnë për fonde të huamarrjes (nga deficitit buxhetor prej 2% - përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (aplikimi për fondet nga klauzola bëhet vetëm për projekte kapitale), është gjithashtu e nevojshme që projektet të plotësojnë kriteret e sipërpërmendura duke përfshirë analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit të cilat duhet të jenë në kuadër të projeksioneve të organizatës buxhetore.

## **5. Programi për investime publike (PIP)**

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në “Deklaratën e

Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2024-2026” në kuadër të KASH-it të jenë bazë për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe identifikimin e projekteve kapitale. Të gjitha organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë kërkesat buxhetore për projektet e tyre në përputhje të plotë me Udhëzimet Administrative dhe kërkesat e PIP-it.

## **6. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB)**

Sistemi SZHMB-se është duke u përshtatur me mënyrën e kalkulimit të pagave dhe shtesave bazuar në Ligjin për pagat në sektorin publik, si dhe rifreskimin e planit kontabël do të jetë në dispozicion për futjen e të dhënave tentativisht nga data 01.06.2023. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren buxhetore.

## **7. Indikatorët e performancës**

Organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe komunal duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Organizatat buxhetore duhet të paraqesin 1 deri në 5 objektiva, të cilat janë të lidhura me strategjitë dhe mbulojnë programet më të rëndësishme. Gjithashtu kërkesat për fonde shtesë nga buxheti duhet të justifikohen në mënyrën se si ato kontribuojnë në arritjen e objektivave. Organizatat buxhetore duhet të rishqyrtojnë aktivitetet në kontekst të arritjes së objektivave. Treguesit e matjes së aktiviteteve duhet të prezantohen në mënyrë konkrete dhe të qartë për çdo aktivitet.

Forma e ofrimit të këtyre informatave dhe një shembull është dhënë në Aneksin 2. Në mënyrë specifike për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen këto informata:

- **Objektivat e outputit** përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore;
- **Treguesit e outputit** matin aktivitetin e institucionit, si p.sh sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit.
  - a) Indikatorit treguesi bazë;
  - b) Indikatorit treguesi i synuar;
- Aktivitetet përshkruajnë veprimet për arritjen e objektivave të deklaruara.

## **8. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)**

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për ”përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve” (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2023. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunat duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2024-2026. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 1. Organizatat buxhetore gjithashtu duhet të publikojnë këto të dhëna.

## **9. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2024-2026**

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2024 dhe për dy vitet në vijim. Ju lutem të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2024-2026.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2024-2026.





## 10. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2024 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2024.

- 29 Prill – aprovimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026 nga Qeveria dhe dorëzimi i KASH-it në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
  - 15 Maj - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2024/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.
  - 26 Qershor- Organizatat buxhetore të dorëzojnë në MFPT kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive të shpenzimeve. Kërkesat buxhetore duhet të jenë plotësisht të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-se dhe PIP-it.
  - 26 Qershor- Departamenti i Makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale.
  - 11 Korrik - Qarkorja buxhetore 2024/02 do të lëshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
  - 25 Korrik- Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë.
  - 21 Gusht – 29 Gusht - Dëgjimet buxhetore (pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të jenë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MFPT, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere. Orari i dëgjimeve buxhetore do t'i bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2024/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2024.
  - 12 Shtator, Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaçërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2024-2026.
  - 18 Shtator – 22 Shtator, konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetor.
  - 26 Shtator, nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor, të cilët mund të ndryshojnë nga qarkorja paraprake.
  - 28 Shtator-3 Tetor Ankesat nga Organizatat Buxhetore.
  - 9 Tetor – 11 Tetor, Takimet e Qeverise për t'i shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore.
  - 16 Tetor, Drafti i parë i buxhetit në MFT dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri.
  - 17 Tetor –24 Tetor - miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri.
  - 27 Tetor - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2023 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë:
- Një tabelë me parashikimet deri në fund vit të implementimit të buxhetit 2023, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet përcjellëse për nën-ekzekutimin apo mbi-ekzekutim nga ndarjet e buxhetit 2023
  - Tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B si dhe Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i SZHMB-së,
  - Tabelat 3.2, 3.2 B dhe Formularët e shtypur nga Sistemi PIP,
  - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator,
  - Tabela e e Indikatorëve të performancës.
  - Kërkesa buxhetore duhet të jetë e konsoliduar në nivel të ëorganizatës buxhetore duke përfshirë agjencionet ekzekutive.
  - Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencise me të gjitha materialet buxhetore.
  - Përshkrimi i kërkesës në formë narrative, ku duhet të paraqiten këto të dhëna:
    - Të arriturat deri më tani me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të parapara në dokumentet strategjike.;

- Çfarë synohet të arrihet me ndarjet buxhetore për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026;
- Organizatat buxhetore duhet të njoftojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve nëse kërkesa buxhetore mbulon vazhdimin e politikave ekzistuese, apo parasheh përfundimin e aktiviteteve vijuese dhe fillimin e aktiviteteve të reja; Për aktivitetet e reja, organizatat buxhetore duhet të theksojnë bazën ligjore (koncept dokument, udhëzim administrativ, projektligj, etj.), dhe të njoftojnë nëse për këtë bazë ligjore është kryer Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2015 për Vlerësimi Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.

Çdo OB udhëzohet të bëjë paraqitjen e propozim buxhetit në MFPT, të miratuar nga një grup pune (ose një komision me emërimin e duhur, gjatë fazës së propozimit të buxhetit) i përbërë nga stafi politik (kabineti i Ministrit), Sekretari i Përgjithshëm, Zyrtari Kryesor Financiar dhe drejtorët e agjencive dhe departam

# Niveli komunal

## Hyrje

Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2024 dhe orientimet për vitet 2025-2026, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2024 si dhe parashikimin afatmesëm 2025-2026.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2024, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve dhe burimeve të financimit për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026,

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2024-2026, dhe të aprovojnë në Kuvendin Komunal deri me datë 30.06.2023 si dokument strategjik komunal, i cili dokument pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

## 1. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2024-2026

### 1.1 Granti i Përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2024 pritet të jenë 2,985.32 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2024-2026 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2021 Rishikuar	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
<b>A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë</b>	<b>1,921.80</b>	<b>2,037.10</b>	<b>2,676.30</b>	<b>2,985.32</b>	<b>3,194.65</b>	<b>3,400.29</b>
<b>Zbriten:</b>						
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	(15.00)	(10.50)	(10.50)	(18.00)	(10.50)	(10.50)
Tatimi në pronë	(30.00)	(41.00)	(44.59)	(49.34)	(50.74)	(53.37)
Grantet e percaktuara të donatorëve			(12.00)	(12.00)	(12.00)	(12.00)
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(48.00)	(46.90)	(54.00)	(56.18)	(58.99)	(61.94)
Të hyrat nga interesi	(3.00)	(3.40)	(3.10)	(3.00)	(2.69)	(2.69)
<b>B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komunal</b>	<b>1,825.80</b>	<b>1,935.30</b>	<b>2,552.11</b>	<b>2,846.80</b>	<b>3,059.73</b>	<b>3,259.80</b>
<b>C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)</b>	<b>182.58</b>	<b>193.53</b>	<b>255.21</b>	<b>284.68</b>	<b>305.97</b>	<b>325.98</b>

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2024-2026 sipas LFPL (mil. Euro)

Faktorët	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Granti i përgjithshëm	182.58	193.53	255.21	284.68	305.97	325.97
Shuma Fikse	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6
Popullsia (banorë)	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
Buxheti: 89% e shumës agregate	159.2	169.0	223.9	250.1	269.1	286.9
Zona komunale (km <sup>2</sup> )	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901
Buxheti: 6% e shumës agregate	10.74	11.39	15.09	16.86	18.14	19.34
Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	107,926	107,926	107,926	107,926
Buxheti: 3% e shumës agregate	5.4	5.7	7.5	8.4	9.1	9.7
Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	62,031	62,031	62,031	62,031
Buxhti: 2% e shumës agregate	3.6	3.8	5.0	5.6	6.0	6.4

Tabela 3 në vijim paraqet shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të paraparë në LFPL.



Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna.

Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi kur është e nevojshme.

### ***1.2 Granti shtesë për financimin e Kryeqytetit***

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, neni 19 Kryeqyteti i Republikës së Kosovës Prishtina përfiton një grant shtesë nga niveli qendror, në lartësi jo më pak se 6% e grantit të përgjithshëm.

Për vitin 2024 Kryeqyteti, Prishtina përfiton grant shtesë prej 17,080,800 euro, ndërsa për vitin 2025 përfiton 18,358,380 euro dhe për vitin 2026 përfiton 19,558,800 euro.

Tabela 4: Shpërndarja e Grantit shtesë për financimin e Kryeqytetit 2024-2026

Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Granti i përgjithshëm për komuna	182.58	193.53	255.21	284.68	305.97	325.98
Granti shtesë për financimin e Kryeqytetit (6%)	10.95	11.61	15.31	17.08	18.36	19.56

### ***1.3 Granti specifik për Arsim parauniversitar***

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2024-2026.

Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 238.5 milion euro si në vijim.

- Paga dhe shtesa në shumë prej 223 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 13.2 milion euro,
- Shpenzime kapitale në shumë prej 2.3 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafilior, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2022/2023;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafilior dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
- q) Praktika profesionale;
- r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
- s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
- t) Specialist të IT-së.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 9,859 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Numri i synuar për reduktim të 485 pozitave të lira (Tabela 5) ka të bëjë me mos plotësimin e tyre duke pas parasysh faktin që këto pozita jen mbi formulën e financimit për arsimin parauniversitar. Po ashtu në rastet kur numri aktual është mbi numrin e lejuar sipas formulës së financimit, me rastin e pensionimit të stafit aktual nuk do të ketë punësim të ri me qëllim të arritjes së synimit për respektimin e numrit sipas formulës së financimit.







#### ***1.4 Granti specifik për Shëndetësi primare***

Propozimi granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 81.96 milion euro, si në vijim:

- Granti bazë do të jetë në shume prej 76.5 milion euro, granti bazë është kalkuluar duke marre për bazë:
  - kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej 62.3 milion euro,
  - koston për vizitë dhe shërbim në shume prej 14.2 milion euro.
- Politikat në vazhdimësi me kosto prej 5.4 milion euro të cilat janë:
  - Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë (vizita x 10 euro) në shumë prej 3.4 milion euro,
  - Vizitat e kujdesit paliativ (vizite x 20 euro) në shumë prej 2 milion euro.

Tabela 7: Të dhënat statistikore për Shëndetësinë primare për vitin 2024-2026

Nr.	Komuna	Popullsia, Standartet për mjek dhe infermier dhe Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor																		
		Popullsia	Demografia						Standartet për mjek dhe infermier							Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor				
			Gjinia			Moshë			Numri i personave me nevoja të vecanta	Standartet 1 MF/ 2000 banorë	Standartet 01 Stomatolog 5000 banorë	Standartet 01 Farmacist në QKMF	Standartet 01 Biokimist në QKMF	Gjithsej Mjek	Infermiere Familjare	Infermier (për mjek specialist, stomatolog, laborator etj)	Gjithsej (mjek dhe infermiere dhe farmacist)	Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)	Qendër e Mjekësisë Familjare (QMF) 10,000 banorë	Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)
			M	F	Femra të moshës riprodhuese 15-49 vjeç	Numri i fëmijëve 0-14 vjeç	Numri i personave të moshuar mbi 65 vjeç													
1	Deçan	40,019	20,123	19,896	10,941	10,471	2,968	50	20	8	1	1	30	40	27	97	1	3	6	
2	Dragash	33,997	17,035	16,962	8,748	8,658	3,139	202	17	7	1	1	26	34	49	109	1	5	8	
3	Ferizaj	108,610	54,841	53,769	23,716	31,566	6,557	1,241	54	24	1	1	80	118	74	272	1	9	5	
4	Fushë Kosovë	34,827	17,621	17,206	9,299	9,996	2,143	293	17	7	1	1	26	34	48	108	1	5	6	
5	Gjakovë	94,556	47,226	47,330	26,654	26,423	12,123	1,130	48	19	1	1	69	94	54	217	1	9	15	
6	Gjilan	90,178	45,354	44,824	19,771	29,288	9,358	1,160	45	18	1	1	65	90	52	207	1	7	10	
7	Gllgovc	58,531	29,733	28,798	18,260	14,317	5,213	211	30	12	1	1	44	60	71	175	1	5	7	
8	Hani i Elezit	9,403	4,836	4,567	1,824	2,778	560	73	5	2	1	1	9	10	7	26	1	0	1	
9	Istog	39,285	19,677	19,608	10,607	10,235	3,093	464	20	8	1	1	30	40	41	111	1	4	8	
10	Junik	6,084	2,995	3,089	1,595	1,681	420	35	3	1	1	1	6	6	8	20	1	0	0	
11	Kaçanik	33,409	16,970	16,439	9,054	9,683	1,940	200	17	7	1	1	26	34	59	119	1	4	8	
12	Kamenicë	36,085	18,600	17,485	16,505	8,900	2,143	360	18	7	1	1	27	36	57	120	1	3	17	
13	Klinë	38,496	19,293	19,203	10,272	11,398	2,606	200	19	8	1	1	29	38	15	82	1	3	9	
14	Leposavic	13,773	6,969	6,804	3,443	2,754	965		7	3	1	1	12	14	15	41	1	0	1	
15	Lipjan	57,605	29,325	28,280	15,355	17,461	7,042	706	29	12	1	1	43	58	65	166	1	4	7	
16	Malishevë	54,614	25,901	28,713	36,430	20,758	3,622	640	35	14	1	1	51	70	29	150	1	6	7	
17	Mamushë	5,508	2,672	2,836	2,543	2,670	737	15	3	1	1	1	6	6	3	15	1	0	0	
18	Mitrovicë	71,909	36,275	35,634	18,624	20,351	5,074	1,200	36	14	1	1	52	72	76	200	1	11	10	
19	Novobërdë	6,730	3,466	3,264	1,726	1,643	732	41	3	1	1	1	6	7	8	21	1	1	0	
20	Obiliq	21,549	10,885	10,664	5,636	6,419	1,239	337	11	4	1	1	17	22	34	73	1	1	4	
21	Pejë	96,451	50,466	45,985	21,930	33,320	10,783	1,047	57	23	1	1	82	116	105	303	1	9	14	
22	Podujevë	88,499	44,955	43,544	23,385	27,061	5,122	879	44	18	1	1	64	88	68	220	1	3	18	
23	Prishtinë	198,897	99,361	99,536	54,800	51,403	25,008	2,143	99	40	1	1	141	198	156	495	1	15	15	
24	Prizren	177,781	89,176	88,605	48,677	49,199	12,502	1,602	89	36	1	1	127	178	116	421	1	15	27	
25	Rahovec	56,208	28,512	27,696	15,393	16,081	3,352	377	28	11	1	1	41	56	77	174	1	7	7	
26	Shtërpcë	6,949	3,554	3,395	1,707	1,777	688	23	3	1	1	1	6	7	8	21	1	0	2	
27	Shtime	27,324	13,850	13,474	5,874	7,877	2,200	38	14	5	1	1	21	28	20	69	1	4	0	
28	Skenderaj	50,858	25,646	25,212	16,515	14,925	4,150	3,758	26	10	1	1	38	52	50	140	1	5	8	
29	Suharekë	59,722	29,478	30,244	16,413	17,409	4,104	610	30	12	1	1	44	60	38	142	1	6	11	
30	Viti	46,987	23,686	23,301	12,310	14,167	3,028	439	23	9	1	1	34	46	25	105	1	4	7	
31	Vushtrri	69,870	36,004	33,866	18,146	19,634	4,508	800	35	14	1	1	51	70	55	176	1	10	9	
32	Zubin Potok	6,616	3,408	3,208	1,456	1,588	476	38	3	1	1	1	6	7	-	13	1	0	0	
33	Zveçan	7,481	3,661	3,820	95	117	45	1	4	1	1	1	7	7	-	14	1	1	0	
34	Graçanicë	10,675	5,428	5,247	2,463	2,661	993	81	5	2	1	1	9	11	-	20	1	3	11	
35	Kllokot	2,556	1,416	1,140	688	670	214	18	1	1	1	1	4	3	7	14	1	0	1	
36	Mitrovica Veriore	12,326	6,272	6,054	2,686	2,931	879	82	6	2	1	1	10	12	10	32	1	0	0	
37	Partesh	1,787	922	865	477	340	202	-	1	1	1	1	4	2	-	6	1	0	2	
38	Ranillug	3,866	1,969	1,897	1,012	393	259	-	-	-	1	1	2	4	-	6	1	0	0	
<b>Total</b>		<b>1,780,021</b>	<b>897,561</b>	<b>882,460</b>	<b>495,030</b>	<b>488,245</b>	<b>150,187</b>	<b>20,494</b>	<b>905</b>	<b>364</b>	<b>38</b>	<b>38</b>	<b>1,345</b>	<b>1,828</b>	<b>1,527</b>	<b>4,700</b>	<b>38</b>	<b>162</b>	<b>261</b>	



### 1.5 Financimi për Shëndetësi sekondare

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 2,603,077 euro sipas propozimit nga MSH dhe projeksioneve të KASH për tri komunat minoritare, si vijon:

- Komuna e Shtërpcës, në shumë prej 522,371 euro,
- Komuna e Mitrovicës së veriut, në shumë prej 989,935 euro, dhe
- Komuna e Graçanicës, në shumë prej 1,090,771 euro.

### 1.6 Financimi për Shërbimet rezidenciale

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat e moshuar dhe shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 3.5 milion euro.

Tabela 9: Financimi për shërbime rezidenciale për vitin 2024-2026

Nr.	Komunat	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Shpenzime Kapitale	Gjithsej 2024	Gjithsej 2025	Gjithsej 2026
Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM)								
1	Skenderaj	95,981	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
2	Graçanicë	74,484	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
3	Istog	95,518	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
4	Novobërdë	73,297	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
5	Prizren	98,283	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
6	Prishtinë	434,127	225,000	50,000	100,000	900,000	1,000,000	1,000,000
<b>Gjithsej SHKPM</b>		<b>871,690</b>	<b>600,000</b>	<b>100,000</b>	<b>175,000</b>	<b>1,900,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>2,000,000</b>
Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara (SHKPAK)								
1	Graçanicë	53,827	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	220,000
2	Deqan	88,318	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
3	Ferizaj	79,096	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	220,000
4	Kamenice	77,272	75,000	10,000	35,000	220,000	200,000	200,000
5	Vushtri	86,434	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
6	Shtime	78,712	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	230,000
7	Lipjan	77,066	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	230,000
8	Prizren	79,200	75,000	10,000	15,000	200,000	200,000	200,000
<b>Gjithsej SHKPAK</b>		<b>619,925</b>	<b>600,000</b>	<b>80,000</b>	<b>140,000</b>	<b>1,620,000</b>	<b>1,600,000</b>	<b>1,700,000</b>
<b>Gjithsej SHKPAK, SHKPM</b>		<b>1,491,615</b>	<b>1,200,000</b>	<b>180,000</b>	<b>315,000</b>	<b>3,520,000</b>	<b>3,600,000</b>	<b>3,700,000</b>

Financimi i kërkuar shtesë si në tabelën e më poshtme (Tabela 10) nga Ministria e linjës për hapjen e shtëpive të reja për personat e moshuar, për personat me aftësi të kufizuara dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve në shume prej 4.5 milion euro do të financohet nga Granti i përgjithshëm, si dhe stafi shtesë do të adresohet përmes rregullimeve të brendshme të komunës (pozitat e lira), pra nuk do të ketë aprovim të pozitive shtesë.

Tabela 10: Hapjen e shtëpive të reja për vitin 2024-2026

Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM)

Nr.	Komunat	Staf	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Shpenzime Kapitale	Gjithsej 2024	Gjithsej 2025	Gjithsej 2026
7	Klinë	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
8	Gjakovë	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
9	Ferizaj	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
10	Podujevë	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
11	Gjilan					230,000	230,000	200,000	200,000
12	Pejë					230,000	230,000	200,000	200,000
13	Mitrovicë					230,000	230,000	200,000	200,000
14	Kaqanik					230,000	230,000	200,000	200,000
15	Vushtri					230,000	230,000	200,000	200,000
16	Fushë Kosovë								250,000
17	Leposaviç								250,000
19	Rahovec							200,000	200,000
<b>Gjithsej SHKPM</b>		<b>52</b>	<b>200,000</b>	<b>180,000</b>	<b>20,000</b>	<b>1,350,000</b>	<b>1,750,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>2,500,000</b>

Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuar (SHKPAK)

9	Malishevë	11	50,000	50,000	5,000	50,000	155,000	200,000	200,000
10	Viti	11	50,000	50,000	5,000	50,000	155,000	200,000	200,000
11	Prishtinë					230,000	230,000	200,000	200,000
12	Glogovc					230,000	230,000	200,000	200,000
13	Gjakovë					230,000	230,000	200,000	200,000
14	Rahovec					230,000	230,000	200,000	200,000
15	Podujeve					230,000	230,000	200,000	200,000
16	Dragash								250,000
17	Mitrovice Veriore								250,000
18	Obiliq							250,000	200,000
19	Pejë							250,000	200,000
<b>Gjithsej SHKPAK</b>		<b>22</b>	<b>100,000</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>1,250,000</b>	<b>1,460,000</b>	<b>1,900,000</b>	<b>2,300,000</b>

Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve (SHEMF)

1	Prishtinë	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
2	Gjilan	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
3	Peje	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
4	Mitrovicë	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
5	Prizren					230,000	230,000	215,000	215,000
6	Ferizaj					230,000	230,000	215,000	215,000
7	Gjakove					230,000	230,000	210,000	210,000
<b>Gjithsej SHEMF</b>		<b>40</b>	<b>210,000</b>	<b>180,000</b>	<b>20,000</b>	<b>890,000</b>	<b>1,300,000</b>	<b>1,500,000</b>	<b>1,500,000</b>
<b>Gjithsej SHEMF, SHKPAK, SHKPM</b>		<b>114</b>	<b>510,000</b>	<b>460,000</b>	<b>50,000</b>	<b>3,490,000</b>	<b>4,510,000</b>	<b>5,400,000</b>	<b>6,300,000</b>

### **1.7 Financimi për Qendrën historike të Prizrenit, Qendrën kulturore të fshatit Zym dhe Keshillin e Hoçës së madhe**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligjit Nr.04/L-196 për Qendrën Kulturore Historike të Fshatit Zym dhe Ligjit Nr. 04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe, me planifikimin e buxhetit për vitin 2024 ndahen mjete financiare në shumë prej 80,603 euro, për dy komunitat si vijon:

- Komuna e Prizrenit, në shumë prej 51,532 euro, dhe
- Komuna e Rahovecit, në shumë prej 29,071 euro.

### **1.8 Financimi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit**

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, neni 9 Obiliqi përfiton nga inkasimi i rentës minerale nga institucioni përkatës, 20% e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës së Obiliqit, e dedikuar në mënyrë specifike për investime në zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njëسيا biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit.

Për vitin 2024 Komuna e Obiliqit bazuar në planifikimin e inkasimit të rentës minerale përfiton financim shtesë prej 5,000,000 euro, për vitin 2025 përfiton shumën prej 5,000,000 euro dhe për vitin 2026 përfiton shumë prej 5,000,000 euro.

### **1.9 Financimi për Teatrot**

Financimi për Teatrot për vitin 2024 është në shumë prej 1.62 milion si në tabelën e bashkangjitur në vijim.

Tabela 11: Financimi për Teatrot për vitin 2024-2026

Nr.	Komunitat	Paga dhe shtesa	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej 2024	Gjithsej 2025	Gjithsej 2026
1	Ferizaj	206,500	37,746	244,246	244,246	244,246
2	Podujevë	119,992	30,757	150,749	150,749	150,749
3	Prizren	202,161	61,785	263,947	263,947	263,947
4	Gjilan	243,295	31,340	274,635	274,635	274,635
5	Gjakovë	233,405	32,862	266,266	266,266	266,266
6	Mtrovicë	199,644	24,991	224,635	224,635	224,635
7	Pejë	162,093	33,520	195,613	195,613	195,613
	Gjithsej	1,367,091	253,000	1,620,091	1,620,091	1,620,091





### 1.11 Financimi përmes klauzolës së investimeve

Për vitin 2024 me mekanizmin e klauzolës së investimeve do të financohen projektet për Eficienc të Energjisë në Ndërtesat Publike në komunën e Prishtinës dhe Prizrenit në shumë prej 2,000,000 euro.

### 1.12 Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2024-2026

Për ndarjen e granteve qeveritare sipas komunave për vitin 2024 janë zbatuar kriteret dhe formulat bazë të përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjet e tjera relevante, si dhe bazuar në projeksionet makro-fiskale dhe të dhënave nga ministritë e linjës:

Tabela 13: Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2024-2026 (mil. euro)

Përshkrimi	Viti 2020	Viti 2021	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Parashikimi për 2024	Parashikimi për 2025	Parashikimi për 2026
<b>1. Grantet qeveritare</b>	<b>463.54</b>	<b>439.99</b>	<b>457.62</b>	<b>526.91</b>	<b>605.16</b>	<b>637.70</b>	<b>669.38</b>
1.1 Granti i përgjithshëm	196.28	182.58	193.53	255.21	284.68	305.97	325.98
Granti i përgjithshëm		182.58	193.53	255.21	284.68	305.97	325.98
1.2 Granti specifik për shëndetësi	61.7	62.6	62.6	70.5	81.965	86.064	90.367
Granti bazë dhe politikat në vazhdim		61.7	62.6	62.6	81.965	86.064	90.367
Politikat e reja		0.9		7.9			
1.3 Granti specifik për arsim	205.56	194.81	201.5	201.2	238.51	245.67	253.04
Granti bazë dhe politikat në vazhdim		191.97	195	194.4	238.5	245.7	253.0
Politikat e reja		2.85	6.5	6.8			
2. Financimi për shëndetësin sekondare	2.6	2.6	2.6	2.6	2.6	2.6	2.6
3. Shërbimet rezidenciale	2.04	2.3	2.3	4.2	3.52	3.6	3.7
4. Financimi për QHP, QKHFZ dhe KHM	0.06	0.069	0.07	0.07	0.08	0.08	0.08
5. Granti për Kryeqytetin- Prishtinën	11.77	11.0	11.6	15.3	17.1	18.4	19.6
6. Financimi për Obiliqin	4.2	4.6	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0
7. Të hyrat vetanake komunale	83.1	78	87.4	98.5	105.5	109.7	115.4
8. Financimi për teatrot	0.9	0.9	0.9	0.9	1.62	1.62	1.62
9. Klauzola e investimeve	11.53	7.4	0	6	2	2	0
<b>Total Financimi Komunal</b>	<b>579.74</b>	<b>546.80</b>	<b>567.50</b>	<b>659.51</b>	<b>742.58</b>	<b>780.69</b>	<b>817.33</b>

Departamenti i Buxhetit në MFPT do të organizojë forume me autoritetet komunale lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2024-2026. Gjithashtu, do të zhvillohen takime konsultuese me zyrtarët financiar të komunave për përcaktimin e strukturës sipas kategorive të shpenzimeve si dhe sipas nevojës do të ofrohen udhëzime më specifike rreth procesit dhe kriterëve të hartimit të buxhetit për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026.

Tabela 14: Burimet e financimit dhe struktura e shpenzimeve për vitin 2024-2026

Totali i Nivelit Komunal	Viti 2022 Shpenzimi	Viti 2023 Buxhetuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar
<b>Total</b>	<b>515,109,826</b>	<b>660,299,800</b>	<b>742,584,562</b>	<b>780,699,931</b>	<b>817,332,272</b>
Numri i të punësuarve	44,404	44,929	44,929	44,929	44,929
Paga dhe shtesa	276,035,366	291,730,961	355,000,000	356,000,000	357,000,000
Mallra dhe shërbime	84,522,537	109,503,454	119,000,000	121,000,000	124,000,000
Shpenzime komunale	11,353,134	14,684,628	17,000,000	18,000,000	19,000,000
Subvencione dhe transfere	18,966,289	27,486,454	31,000,000	33,000,000	35,000,000
Shpenzime kapitale	124,232,500	216,252,303	220,584,562	252,699,931	282,332,272
Rezerva		642,000			
<b>Burimet e financimit</b>	<b>515,109,826</b>	<b>660,299,800</b>	<b>742,584,562</b>	<b>780,699,931</b>	<b>817,332,272</b>
Garantet qeveritare	460,797,180	555,780,538	635,060,985	668,965,175	701,945,778
Të hyrat vetanake	53,673,786	98,519,262	105,523,577	109,734,756	115,386,494
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	638,860	6,000,000	2,000,000	2,000,000	

### 1.13 Kalendari kohor për nivelin komunal

Organizatet buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- 30 Qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2024-2026 nga Kuvendi Komunal,
- 30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dokumentet si në vijim:
  - Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
  - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2024-2026, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
  - Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
    - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2024-2026 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
    - Tabela 4.1.B - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve përmes klauzolës së investimeve,
    - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2024 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2025-2026 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
    - Tabela 4.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve,
    - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
    - Tabelat e Buxhetimit sipas performancës,
    - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator.

**Shembull:**

Aneksi 1

**Buxheti i Përgjegjshëm Gjinator**Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse  
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2021					
2022					
2023					
Planifikimi për 2024					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2024- Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore  
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

[Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2021						
2022						
2023						
Planifikimi për 2024						

## Aneksi 2

### INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

Tabela 5. Treguesit kyçë të performancës që përshkruajnë rezultatet e pritura të organizatës buxhetore për vitet 2024-2026 (shih dy shembujt në tabelën e mëposhtme)

Prioriteti 1 i Qeverisë - Reduktimi i ekonomisë joformale për 20 % për periudhën 2024-2026 dhe përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes						
Nr.	Emri i treguesit të produktit dhe njësia matëse	Burimet e financimit	2023 (N) (i pritur)	2024 (N+1) (synuar)	2025 (N+2) (synuar)	2026 (N+3) (synuar)
1	2	4	5	6	7	8
	2,750 inspektime	Granti Qeveritar	600 inspektime	650 inspektime	700 inspektime	800 inspektime
	1,200 Fushata vetëdijësuese	Granti Qeveritar	300 fushata	300 fushata	300 fushata	300 fushata
Rezultati, rritja e përfshirjes e fëmijëve në edukimin e hershem para fillor 0-6 vjeç për 30 % për vitet 2024-2026						
Nr.	Emri i treguesit të produktit dhe njësia matëse	Burimet e financimit	2023 (N) (i pritur)	2024 (N+1) (synuar)	2025 (N+2) (synuar)	2026 (N+3) (synuar)
1	2	4	5	6	7	8
	30 çerdhe për fëmijët parashkollor	Grantet Qeveritare	6 çerdhe për fëmijët parashkollor	7 çerdhe për fëmijët parashkollor	8 çerdhe për fëmijët parashkollor	9 çerdhe për fëmijët parashkollor
	8 çerdhe për fëmijët parashkollor	IPA/BE	2 çerdhe për fëmijët parashkollor	2 çerdhe për fëmijët parashkollor	2 çerdhe për fëmijët parashkollor	2 çerdhe për fëmijët parashkollor